LIGJ
Nr.10 442, datë 7.7.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8669, DATË 26.10.2000 "PËR CENSUSIN E PËRGJITHSHËM TË POPULLSISË DHE BANESAVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pikat 1 e 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8669, datë 26.10.2000 "Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në titull dhe kudo në ligj fjala "regjistrim" zëvendësohet me fjalën "census".

Neni 2

Në nenin 1, pika 3 shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 3, pas shkronjës "b" shtohen shkronjat "c", "ç" dhe "d" me këtë përmbajtje:

"c) "Census" është mbledhja e informacionit me anë të pyetësorëve dhe përpunimi i të dhënave të tilla, në mënyrë që të sigurojë një numërim të plotë të të gjithë individëve, familjeve e banesave dhe të ndërtesave të shfrytëzuara për qëllime banimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në një moment të vetëm në kohë, si dhe prodhimi i statistikave në lidhje me karakteristikat demografike, ekonomike dhe sociale të popullsisë së Shqipërisë.

ç) "Dita e censusit" është dita e parë e fillimit të punës në terren.

d) "Momenti i censusit" është ora 00:00 e mesnatës, që paraprin ditën e censusit.".

Neni 4

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 4
Detyrimi për t'u përgjigjur

Të gjithë personat me shtetësi shqiptare apo të huaj, si dhe personat pa shtetësi, me përjashtim të personelit diplomatik të akredituar në Shqipëri, të cilët në momentin e censusit ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të japin informacionin e kërkuar në pyetësorët e censusit të popullsisë dhe të banesave, të miratuar nga Komisioni Qendror i Censusit, në përputhje me shkronjën "e" të nenit 12 të këtij ligji:

a) në mënyrë të plotë;

b) në mënyrë të saktë dhe të besueshme.".

Neni 5

Neni 6 shfuqizohet.

Neni 6

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8
Kategoritë e të dhënave dhe përdorimi i tyre

1. Të dhënat e mbledhura nga censusi kategorizohen në:
a) identifikuese dhe personale të individëve;
b) identifikuese dhe strukturore të ndërtesave, banesave, banesave të jetesës kolektive.
2. Të dhënat e mbledhura nga censusi do të përdoren vetëm për qëllime statistikore, në përputhje me ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikat zyrtare", dhe me standardet e rekomandimet ndërkombëtare.
3. Të dhënat e mbledhura nga censusi nuk do të përdoren për asnjë listë elektorale ose për përditësimin e asnjë regjistri të gjendjes civile dhe të asnjë regjistri tjetër administrativ.".

Neni 7

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 9
Mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti

1. Konfidencialiteti i të dhënave të grumbulluara nga censusi është i mbrojtur nga dispozitat e këtij ligji dhe nga legjislacioni në fuqi.
2. Çdo person ose autoritet publik, që, përmes përfshirjes në proceset e censusit, ka dijeni mbi të dhëna personale, i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit mbi to, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikat zyrtare" dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
3. Konsiderohen shkelje e detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit, sipas përcaktimit të pikës 2 të këtij neni, edhe rastet kur personi, pas përfundimit të marrëdhënieve të punësimit, që, për qëllime të censusit apo të çdo marrëdhënieje tjetër me censusin, nuk ruan konfidencialitetin mbi të dhënat personale për të cilat ka dijeni.
4. INSTAT-i merr të gjitha masat e duhura teknike, organizative dhe të sigurisë, për të parandaluar hyrjen e paautorizuar në instalimet, ku të dhënat personale të censusit mbahen, përpunohen ose ruhen dhe për t'i mbrojtur ato nga shkatërrimet e paligjshme, aksidentale, humbjet aksidentale, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.
5. INSTAT-i, pasi të ketë marrë masat e duhura për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave, i bën ato anonime, pas fshirjes nga dosjet elektronike të çdo elementi identifikues, të përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji.
6. Të dhënat anonime mund t'i vihen në përdorim një pale të tretë të autorizuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikat zyrtare", vetëm për veprimtari, në përputhje me nenin 1 të ligjit.
7. Të gjitha të dhënat identifikuese dhe personale, të mbledhura nga censusi, mbahen nga INSTAT-i për një periudhë që është e nevojshme për përpunimin e tyre dhe ruhen, sipas afateve kohore të përcaktuara në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat".

Neni 8

Në nenin 10, shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:
"b) Rezultatet statistikore, të përcaktuara në shkronjën "a" të këtij neni, publikohen në nivel kombëtar dhe në nivel vendor, duke siguruar që ato të jenë të paraqitura në një formë, që përjashton identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të individit.".

Neni 9

Neni 11 shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:

“e) Cakton datën e censusit, miraton kalendarin e veprimtarive për përgatitjen dhe zbatimin e censusit dhe përmbajtjen e pyetësorit të censusit, të propozuar nga INSTAT-i.”.

2. Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) Përbërja, funksionimi, organizimi dhe detyrat, që do të kryejë Komisioni Qendror i Censusit, në përputhje me kompetencat e parashikuara në këtë nen, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 11

Në nenin 13, në fillim të shkronjës “d” shtohen fjalët si më poshtë:

“përpunon të dhënat e mbledhura nga censusi dhe”.

Neni 12

Në nenin 14, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) Monitoron procesin e përzgjedhjes, të rekrutimit dhe të trajnimit të kontrollorëve dhe miraton listën e kontrollorëve të paraqitur nga komisioni *ad hoc* i vlerësimit, në përputhje me pikën 2 të nenit 18 të këtij ligji.”.

Neni 13

Në nenin 15, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) Monitoron procesin e përzgjedhjes, të rekrutimit dhe të trajnimit të anketuesve dhe miraton listën e anketuesve të paraqitur nga komisioni *ad hoc* i vlerësimit, në përputhje me pikën 2 të nenit 18 të këtij ligji.”.

Neni 14

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16
Informimi

1. Qëllimet dhe procedurat e censusit, si dhe detyrimet juridike lidhur me të bëhen publike nëpërmjet mediave dhe një fushate të gjerë informimi, të drejtuar nga INSTAT-i.

2. Fushata informuese fillon 8 javë para ditës së censusit dhe përfundon me nxjerrjen e rezultateve paraprake të censusit.”.

Neni 15

Neni 17 shfuqizohet.

Neni 16

Në nenin 18, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. INSTAT-i përcakton kriteret dhe ngre një komision *ad hoc* vlerësimi për çdo qark, bashki dhe komunë për përzgjedhjen, rekrutimin e personelit të censusit, të cilët emërohen si më poshtë:

a) Emërimi i anketuesve bëhet nga INSTAT-i, në bazë të listës së miratuar nga zyrat e censusit në bashki dhe komuna;

b) Emërimi i kontrollorëve bëhet nga INSTAT-i, në bazë të listës së miratuar nga komisioni i censusit në qark;

c) Emërimi i mbikëqyrësve, i operatorëve, i personelit drejtues, i ekspertëve shkencorë, si dhe i personelit tjetër që angazhohet në procesin e censusit bëhet nga INSTAT-i.”.

Neni 17

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 20
Kundërvajtjet

Përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen, përkatësisht, me gjobë shkeljet e mëposhtme:

1. Refuzimi për të bërë deklarim ose deklarimi i rremë dënohet me gjobë prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh.

2. Mosrespektimi i rregullave të konfidencialitetit, të përcaktuara në nenin 9 të ligjit, nga personi/personat përgjegjës dënohet me një gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

3. Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në nenin 19 të këtij ligji nga personi/personat përgjegjës dënohet me gjobë nga 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë.

4. Për hetimin administrativ të kundërvajtjeve, INSTAT-i ka të drejtë të konsultojë bazat e të dhënave shtetërore në Republikën e Shqipërisë.".

Neni 18

Pas nenit 20 shtohet neni 20/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 20/1
Vlerësimi i kundërvajtjeve administrative

1. INSTAT-i është përgjegjës për shqyrtimin e çdo dokumenti që vërteton kundërvajtjen administrative, në përputhje me nenet 4 e 20 të këtij ligji, dhe për vendosjen e ekzekutimin e gjobave zbaton procedurat e ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

2. INSTAT-i është përgjegjës për konstatimin e kundërvajtjes administrative, në përputhje me nenin 9 të ligjit, dhe e referon rastin pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.".

Neni 19

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 21
Ankimi ndaj sanksionit për kundërvajtjen administrative

1. Ankimi ndaj një vendimi të INSTAT-it për vendosjen e një gjobe, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 3 të nenit 20 të këtij ligji, paraqitet në Komisionin Qendror të Censusit brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së këtij vendimi.

2. Kundër vendimit që ka marrë Komisioni Qendror i Censusit, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të paraqitet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së këtij vendimi.

3. Ankimi ndaj vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vendosjen e gjobës, në përputhje me pikën 2 të nenit 20 të këtij ligji, kryhet sipas procedurave të parashikuara në nenin 40 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 20

Neni 23 shfuqizohet.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7057, datë 27.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi